



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 130 dt.28.04.1994

**MBI**

**“RIORGANIZIMIN E NDERMARRJES SE DEKOR – FUNERALIT”**

Këshilli Bashkiak, pasi u njoh me relacionin e paraqitur nga Komisioni i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Vendimin e Këshillit Drejtues të Ndërmarrjes, duke gjykuar që organizimi i kësaj ndërmarrje është i nevojshëm në zbatim të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” Nr.7572, dt.28.04.1994, neni.14 si dhe të Ligjit “Për ndërmarrjet shtetërore” Nr.7582, dt.13.07.1992 , neni.30,

**VENDOSI**

1. Të miratojë ndarjen dhe riorganizimin e së Dekor – Funeralit në dy ndërmarrje të veçanta si më poshtë :

- 1.Ndërmarrja e Dekorit
- 2.Ndërmarrja e Shërbimeve Funerale

- 1.Aktiviteti i Nd.Dekorit :

- 1.Dekori i qytetit
- 2.Qarkullimi rrugor
- 3.Reklamat tregtare

4.Prodhimi dhe vendosja e materialeve për Partitë e ndryshme

2.Aktiviteti i Nd.Shërbimeve Funerale do jetë :

- 1.Organizimi i ceremonive të varrimit
- 2.Mirëmbajtja e varreve dhe varrezave publike
- 3.Ndërtimi i varrit fillestar dhe varreve relikeve në përputhje me kërkesat e qytetarëve.

2. Mjetet themelore do të ndahen :

### 1.Ndërtesat

Nd. Dekorit : kapanoni dekorit, magazina, ish lavanteri, (pikturë) Parkingu Nr.1, magazina 2 katëshe. Gjithsej 1.600.240 lekë.

Nd.Funeralit : Zyra funerale, magazina shallvare, varreza Sharrë, varreza Tufinë, Parking Nr.2, zdrukhtaria. Gjithsej 1.152.180 lekë.

### 2.Mjetet e transportit

Nd. Dekorit : Makinë Zuk (1 copë)dhe veturë 1 copë 151.734 lekë.

Nd. Funeralit : Autobus shoqërimi (6 copë), makina të zeza (4 copë), kamion IF (1 copë), makinë zuk (1 copë). 114.085.263 lekë.

### 3.Makineritë

Nd. Dekorit : Piktura, fototekstil, zdrkhtaria piktura 124.389 lekë.

Nd. Funeralit : Varreza Sharrë, Varreza Tufinë, zdrukhtaria, kurorat 52.964 lekë.

### 4.Inventar ekonomik e tjera

Nd. Dekorit : 61.262 lekë

Nd. Funeralit : 34.863 lekë

<u>5.Fuqia Punëtore</u>	<u>Dekori</u>	<u>Funerali</u>
Punëtorë	43	131
Administratë	9	10

6.Drejtor i Nd. Dekorit do të jetë :

Perikli Shomo – Ing. Kimist

7.Drejtor i Nd. Funeralit do të jetë :

Tonin Gurakuqi – Arsim mesëm ndërtimi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**